




RAPORTI VJETOR I PUNËS I KRYETARIT

(janar – dhjetor 2024)



DHJETOR 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	1
ZOTIMET	2
PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS.....	2
PRIORITETET PËR VITIN 2025	3
SYNIME PËR VITIN 2025.....	4
SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2025.....	5
ZYRA E KRYETARIT	6
Zyra Ligjore.....	6
Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit.....	6
Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura	6
ZYRA PËR INFORMIM	9
Lektorimi	12
Zyra e Auditimit të Brendshëm	13
Zyra e Prokurimit.....	13
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.....	13
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË	13
Spektori I Gjendjes Civile	13
Spektori për Punë të Kuvendit dhe të Komiteteve	14
Spektori për IT	14
Qendra për Shërbime me Qytetarë	14
Spektori për Barazi Gjinore	14
DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET	15
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE.....	16
DREJTORIA PËR ARSIM.....	17
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM	17
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	19
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....	19
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	20
DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË	22
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	23
DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE.....	23
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	24

Fjala hyrëse

Qytetarë të komunës së Rahovecit,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale 2024, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin vjetor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – dhjetor 2024.

Raporti pasqyron aktivitetet dhe angazhimet Kryetarit, të drejtorive komunale në Komunën e Rahovecit si dhe njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.

Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvizojë, përparimin e arritur në realizimin e prioritetëve të Komunës, ballafaqimeve me vështirësitë dhe përpjekjet për t'u dhënë zgjidhje një sërë çështjesh me interes publik dhe ka si pikë reference Programin Qeverisës.

ZOTIMET

- Komunë e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejt dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë që u shërben qytetarëve pa dallim;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Komunë ku promovohen politikat dhe praktikatat më të mira, si dhe standardet e larta të qeverisjes;
- Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;
- Komunë pa diskriminim, e që qytetarët i trajton barabartë;
- Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;
- Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri;
- Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevojë të veçanta;
- Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identitet i Rahovecit;
- Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;
- Komunë ku përkushtimi për të vepruar ndershmëri dhe në pajtim me ligjin, veçse vullnet, përcaktim i të zgjedhurve, jetësohet edhe si detyrim moral ndaj zgjedhësve si dhe ndaj ligjit;
- Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;
- Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

- Bujqësia;
- Ekonomia, agroturizmi dhe punësimi;
- Administratë bashkëkohore me shërbime të shpejta dhe cilësore;
- Arsimi, shëndetësia dhe përkujdesja sociale;
- Infrastrukturë publike të rregulluar dhe të mirëmbajtur;
- Investime nga fondi i eficiencës së energjisë në sektorin publik dhe privat;
- Investime në infrastrukturë kulturore, sportive dhe hapësira për të rinjtë, si dhe rritja e përkrahjes për këta sektorë;
- Promovimi i potencialit dhe i mundësive për investime nga mërgata jonë;
- Trashëgimia kulturore, historike dhe investime për ta nderuar hartën e sakrificës dhe të lirisë.

PRIORITETET PËR VITIN 2025

- Sheshi Qendror i Qytetit;
- Ndërtimi i Ballkonit panoramik;
- Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Rini, Art dhe Inovacion;
- Funksionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim të hapësirave publike;
- Mirëmbajtje dhe menaxhim të vlerave kombëtare historike dhe të luftës çlirimtare (komplekset përkujtimore, muzetë, monumentet e trashëgimisë kulturore historike, lapidarët, varrezat e dëshmorëve dhe të martirëve etj.
- Edukim dinjitoz i brezave të rinj, duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithëpërfshirëse;
- Përmirësim i infrastrukturës së institucioneve shkollore
- Bursa për studentë;
- Bibliotekat – kujdes i shtuar për bibliotekat, duke u përkujdesur për blerjen e titujve të rinj, por edhe duke i mirëmbajtur dhe investuar në objektet e bibliotekave ekzistuese;
- Laboratorë dhe kabinete – do të investojmë në zhvillimin dhe krijimin e laboratorëve të rinj për shkencat natyrore dhe në kabinete;
- Përkrahje e fermerëve me serra, inpute bujqësore dhe farëra;
- Rugë fushore;
- Përkrahje për pikat grumbulluese të qumështit;
- Kanale të kullimit të tokave bujqësore;
- Shërbime veterinarë periodike falas;
- Konsulencë dhe hartim të projekteve falas për bujq dhe biznese;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj.;
- Bashkëpunim me KRU “Gjakova” dhe me donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Eficienca e energjisë në objekte publike dhe në sektorin privat, përmes fondit të EE-së dhe të mileniumit;
- Mirëmbajtje e rregullt e hapësirave publike, e objekteve publike dhe e të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;
- Legalizimi i parkingjeve ekzistuese dhe krijimi i parkingjeve të reja;
- Rregullimi i mëtejshëm i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta;
- Investime të tjera në kanalizimin e ujërave të zeza dhe në disa rrugë në pjesë problematike të qytetit;
- Mjedisë të bukura dhe hapësira për të rinjtë;
- Kënde lojërash për fëmijë;
- Rritje e numrit dhe e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit sa më të mirë dhe profesional;
- Rritje e përkrahjes në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit, përmes përkrahjes së të rinjve, shoqatave kulturoro-artistike dhe klubeve sportive;
- Rritje e subvencionimit për projekte kulturoro-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
- Vazhdim i zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2021-2025;
- Përkrahje dhe lehtësira për prodhuesit, tregtinë, zejet e veçanta, artizanalet, etj.;
- Trajtim dhe rregullim i shtretërve të lumenjve dhe përrenjve;
- HZK - do të miratohet Harta Zonale e Komunës, pas shqyrtimit publik;

- Plotësim-ndryshimi i rregullores së Komunës së Rahovecit;
- Rritja e kapaciteteve inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, për të parandaluar e mbrojtur nga ndotësit e shkatërruesit e tij, me shqiptim të gjobave mandatore;
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne,
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë,
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit,
- Realizim i planit të të hyrave komunale,
- Promovimi dhe përmirësimi i mjedisit të Rahovecit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të reja;
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm;
- Komunikim dhe bashkëpunim me OJQ - të.

SYNIME PËR VITIN 2025

- Bujqësi të përkrahur;
- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore;
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore;
- Në bashkëpunim me donatorët do të anagazhohemi për zgjerimin e sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon;
- Përfundimi i ndërtimit të shkollave të reja;
- Funksionimi i repartit të hemodializës;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përrrenjve;
- Barna esenciale për qytetarët në nevojë nga buxheti i komunës;
- Investime në rritjen e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e tyre, pajisje mjekësore dhe inventarizim për QKMF-në dhe rrjetin e shërbimeve parësore shëndetësore;
- Arsim cilësor dhe biblioteka, pajisje bashkëkohore, laboratorë, më shumë teknologji informative dhe mjete konkretizimi në shkolla;
- Hartimi i planeve specifike komunale;
- Zhvillim ekonomik dhe punësim nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së sektorit privat;
- Investime për zhvillimin e planifikuar të agroturizmit;
- Rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale;
- Funksionalizimi i lokaleve afariste te stacioni i autobusëve;
- Funksionalizimi i qendrës së magazinimit – depos bujqësore;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe me Drejtorinë për Punë inspektuese, legalizimi i objekteve pa leje dhe respektimi i ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje;
- Mbikëqyrje aktive dhe rritje e cilësisë në investimet publike;
- Vazhdimi i evidentimit dhe i lirim të pronave të uzurpuara;
- Dyfishim i përpjekjeve për mbrojtje të mjedisit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e pronës publike, parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera;
- Projekte me partneritet publiko-privat;
- Hartimi i planeve, nxjerrja e akteve dhe e rregulloreve të tjera;
- Zhvillimi i Rahovecit në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe menaxhimi i burimeve fizike bazuar mbi parimet e shëndosha mjedisore, si dhe mbi parimet e partneritetit me mekanizma vendorë e ndërkombëtarë, për realizimin e vizionit për komunë model me një qeverisje cilësore, efikase dhe llogaridhënëse;

- Vazhdimi i trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe të përrenjve, përmes investimeve kapitale nga komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit.

SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2025

- Buxheti i ulët i Qeverisë së Kosovës, mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare nga qeveria qendrore, si trend i vazhdueshëm në Kosovë, që i bën investimet edhe më të vështira (angazhime të shtuara në kërkesa nga qeveria qendrore);
- Integrimi i sa më shumë qytetarëve dhe thellimi i bashkëpunimit të ngushtë me organizatat joqeveritare (OJQ-të), bizneset, zanatlinjtë, tregtarët, bujqit, shoqërinë civile etj.;
- Mungesa e hapësirave publike në territorin e komunës së Rahovecit;
- Mungesa e burimeve të nevojshme njerëzore dhe profesionale;
- Përfshirja më e madhe e qytetarëve tanë në aktivitetet tona dhe duke i mbajtur ata të informuar për zhvillimet në komunën tonë.

ZYRA E KRYETARIT

Zyra Ligjore

Vendime për kryetarin e Komunës	492
Vendime për Kuvendin e Komunës	81
Urdhëresa	77
Autorizime	19
Akte përcjellëse	16
Marrëveshje	10
Propozime për Kuvend	44
Kërkesa	7
Kontrata	16
Konsultime	permanente
Përgjigje në kërkesa	13
Njoftime	9
Vendime për drejtori	34
Deklarata	1
Vërtetime	4
Puna në komisione	29
Opinion ligjor	1
Totali i akteve të hartuara:	853

Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

Janë shpallur 67 konkurse publike, prej të cilave 14 në Shërbimin Civil, 48 konkurse në Drejtorinë për Arsim, si dhe 5 në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Njësia e Personelit i shpall konkurset publike edhe për sektorin e Arsimit dhe sektorin e Shëndetësisë, në programin elektronik: hrms.rks.gov.net;

Janë hartuar gjithsej 280 shkresa administrative, si në vijim: kontrata, vërtetime, vendime, draft-vendime, propozime, aktemërimë, informata, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa të tjera, si dhe ka dërguar mbi 220 emaile zyrtare; Kemi pasur 18 raste të vlerësimit të punës provuese për punëtorët që i kanë bërë një vit pune në komunë;

Njësia e Personelit menaxhon me programin elektronik *HRMIS*; menaxhon me programin elektronik: hrms.rks.gov-net, ku realizohen procedurat e rekrutimit; monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punë, të punëtorëve (sistemi SMVP); menaxhon (një pjesë) me programin *SMAED*; monitoron me programin elektronik *PYROLL*, pra me programin e listave të pagave.

Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

1. PASQYRA TABELARE (SI MË POSHTË) PËR TË GJITHA REGJISTRAT, PARAQET LËNDË NË PUNË, TË PRANUARA, TË KRYERA, TË PAKRYERA DHE LËNDË TË MBETURA, SI DHE PASQYRA PËR VEPRIMET E NDËRMARRA.

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE

Sipas regjistrave të ZPL		Civile	Përbarimore	Konflikt Administrativ	CN Ndryshme	Proc.At hezionit	Komerciale ekonomike	Gjithsej lëndë të administruara:
1	Lëndë të pazgjidhura-të bartura	1390	332	13	34	17	5	1791
2	Lëndë të pranuara	983	2086	0	0	0	3	3072
3	Të gjitha lëndët në punë	2373	2418	13	34	17	8	4863
4	Lëndë të zgjidhura	1011	1245	0	0	0	2	2258
5	Lëndë të mbetura	1362	1173	13	34	17	7	2606

2. LËNDË TË REJA TË PRANUARA GJATË VITIT 2024:

PADI TË REJA SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE								
	Lëndë të reja të pranuar gjatë periudhës raportuese	Civile	Përbarimore	Konflikte Administrative	Civile Ndryshme	Proc.At_hezionit	Komerciale ekonomike	Gjithsej lëndë të administruara:
1	Vërtetim i pronësisë	10						10
2	Kompensimet sipas Kontratës Kolektive	959	2086					2709
3	Konteste pune	4						4
4	Lëndë të tjera	10	4	2	0	0	7	10
5	Komuna paditëse/kreditore	0	0	0	0	0	0	0
	Gjithsej:	983	2090	2	0	0	7	2733

3. PASQYRA E AKTIVITETEVE SIPAS REGJISTRAVE PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

PARASHITRESA TË PRANUARA	CIVILE	PËRMBARIMOR E	KONFLIKTE ADMINISTRATIV E	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Komerciale ekonomike	GJITHSEJ:
Aktivendim+Aktgjykim I	1326	165	1	1	0	1	1494
Aktivendim+Aktgjykim II	118	3	1	1			123
Aktivendim+Aktgjykim III	5		0	0			5
Aktgjykim+Aktivendim DHPGJS	0						0
Urdhër përbarimor		2086					2086
Aktivendim E për lejimin e përbarimit		0					0

Aktvendim për 180 ditë	0						0
Padi me prova	776		0	0			776
Aktvendim për përgjigje në padi	147		0	0			147
Përgjigje në ankesë C	24		0	0			24
Përgjigje në ankesë P		2					2
Përgjigje në prapësim		0					0
Përgjigje në revizion	1						1
Përgjigje në propozim për ML	0						
Precizimi i padisë	88		0				88
Prapësim i debitorit		2					2
Ankesë C e paditësit	25						25
Ankesë P e kreditorit		1					1
Revizion C i paditësit	2			0			2
Ekspertizat	6	31		0			37
Aktakuzë					0		0
Parashtresat e tjera	30	1		0			31
	2548	2291	2	2	0	1	4844

Të gjitha shkresat e pranuar janë sistemuar nëpër lëndë përkatëse dhe është vepruar në interes të Komunës varësisht nga rasti. Vendimet e pranuar gjyqësore të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë pas analizimit të tyre, ato të cilat kanë qenë në dëm të Komunës janë ankumuar në shkallë tjetër gjyqësore.

PARASHTRESA TË DËRGUARA	CIVILE	PËRMBARIM ORE	KONFLIKTE ADMINISTRATIVE	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Departamenti Ekonomik	GJITHSEJ:
Ankesat	225	2	0	0	0	0	227
Përgjigje në ankesë	0		0	0			0
Përgjigje në padi	983		0	0			983
Mbrojtje në padi DHP GJS	0						0
Revizion	5						5
Përgjigje në revizion	0		0				0
Propozim për ML	2		0				2
Përgjigje në ML	0						0
Prapësime		168					168
Përgjigje në prapësim		0					0
Ushtrimi i kundërpërmbartimit		3					3
Ushtrimi i padisë	0						0
Kundërpadi	1						1
Kallëzim Penal					0		0
Ushtrimi i propoz. për përmbartim	0	0					0
Parashtresat e tjera	9	1	0	0	0	0	8
Gjithsej:	1066	173	0	0	0	0	1397

Seancat e caktuara nga kontestet civile, përmbartimore etj. nga gjykatat për periudhën raportuese.

Për të gjitha lëndët aktive, gjykatat kanë caktuar dhe janë mbajtur seancat gjyqësore në të cilat Komuna është e paditur ose paditëse, si në vijim:

Seancat gjyqësore gjatë vitit 2024	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej:
Nr. i seancave të mbajtura:	6	5	11	11	10	3	9	4	4	9	11	0	83
Sipas kontesteve - seanca të caktuara/mbajtura													
Civile	83												
Përmbartimore	0												
Konflikte Administrative	0												
Civile – të ndryshme	0												
Proc. At hezionit	0												
Gjithsej:	83												

ZYRA PËR INFORMIM

Janë publikuar: aktivitete-dokumente:

Lajme	Njoftime	Dok. financiare	Thirrje	Konkurse	Plane	Takime/Dëgji me Konsultime	Raporte	Kërkesa QDP	Vendimet e Kryetarit	Aktivitete gjithsej:
300	90	18	20	30	14	22	44	31	492	1061

PERFORMANCA KOMUNALE

Transparenca Komunale -2024

Referenca 2.1.2.	Janar – nëntor 2024	Për muajin dhjetor 2024
Numri i kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente publike në komunë gjatë vitit.	31 kërkesa për qasje në dokumente publike Me qasje të plotë: 31 Qasje të pjesërishtme: 0	Deri në fundvit pritet të kemi ende
Numri i dokumenteve që komuna iu ka dhënë qasje plotësisht apo pjesërisht sipas kërkesës.	Me qasje të plotë: 31 Qasje të pjesërishtme: 0	Deri në fundvit pritet të kemi ende
3. Publikimi i raportit për qasje në dokumentet publike.	Raportet tremujore janë publikuar në vazhdimësi në këtë link: https://kk.rks-gov.net/rahovec/?page_id=100042842	Raporti vjetor publikohet në janar

Referenca 2.1.3.		
1. Të dhënat e përditësuara për veprimtarinë publike të institucionit	Gjatë gjithë kohës përditësohet me të dhëna të reja faqja ueb zyrtare dhe ka raste që edhe duhet formohen vjeggëza të reja për të publikuar dokumente në rubrikat përkatëse. https://kk.rks-gov.net/rahovec/tr/	
2. Struktura organizative e komunës	Komuna e Rahovecit funksionon sipas këtij organogrami https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2019/01/Organogrami-Komuna-Rahovec.pdf	
3. Strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave të miratuara në fushën e veprimit dhe funksionit të institucionit publik	Në vjeggëzën https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=31491 janë të publikuara plane të cilat ishin dhe iu nënshtruan konsultimit publik gjatë vitit 2024 Plani i Veprimit për Mbrojtje Kundër Dhunës në Familje; Propozim-plani profesional për kanionin e Drinit të Bardhë; Projekt-plani i Veprimit Lokal për Mjedis	
4. Lista e hollësishme e shërbimeve që ofron institucioni për publikun	Në këtë vjeggëz gjeni listën e hollësishme https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/02/Lista-e-Sherbimeve-Komunale-2024.xlsx	
Referenca 2.1.5.	Janar – dhjetor 2024	Për muajin dhjetor 2024
Gjithsej numri i akteve të nxjerra nga kryetari i komunës që janë me interes të përgjithshëm për publikun	Nga kryetari i Komunës janë nënshkruar 492 akte-vendime, vendimet çdo fillimmuaj janë dërguar në ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, përmes këtij emaili: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net ,	Pritet të nënshkruhen dhe të tjera deri në fundvit
2. Gjithsej numri i akteve të publikuara, nga aktet e nxjerra me karakter të përgjithshëm nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës	Gjithsej numri i akteve të nxjerra me karakter të përgjithshëm të publikuara është 492 , në këtë vjeggëz https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/12/Lista-e-vendimeve-per-muajin-Nentor-2024.pdf	
Referenca 2.1.1.	Janar – dhjetor 2024	Për muajin dhjetor 2024
Korniza Afatmesme Buxhetore - data e publikimit	Korniza Afatmesme Buxhetore u publikua më 15.8.2024 https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/06/KAB-2025-2027.pdf	
Buxheti vjetor i komunës - data e publikimit	Përgjigja: Buxheti vjetor i Komunës u publikua më 7.10.2024 në tri versionet: Pdf: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/10/Buxheti-i-Komunes-se-Rahovecit-per-vitin-2025-i-Aprovuar-me-Date-24.09.2024.pdf https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/10/Plani-i-shperndarjes-totale-te-Buxhetit-2025-2027-F-003-29.06.2024-PDF.pdf Scan: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/10/Plani-i-shperndarjes-totale-te-Buxhetit-2025-2027-F-003-29.06.2024-scan.pdf Excel: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/10/Plani-i-shperndarjes-totale-te-Buxhetit-2025-2027-F-003-29.06.2024.xlsx	
Lista e investimeve kapitale - data e publikimit	Të bashkëngjitur e gjeni linkun me listën e investimeve kapitale: PDF: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/10/Investimet-Kapitale-per-Komunen-e-Rahovecit-2025.pdf SCAN: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/10/Investimet-Kapitale-per-Komunen-e-Rahovecit-per-vitin-2025-scan.pdf	

	EXCEL: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/10/INVESTIMET-KAPITALE-2024-2025-2026-2027-BARAZIMI-09.08.2024-FINALE.xls	
4. Raportet periodike (tremujore) financiare - data e publikimit	- 1.T-3 i publikuar më 8.4.2024: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/04/Raporti-financiar-Janar-Mars-2024.pdf - https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/04/Raporti-Financiar-Janar-Mars-2024-Scan.pdf - https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/04/Raporti-financiar-Janar-Mars-2024.docx - 2.T-6 i publikuar më 10.7.2024: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/07/Raporti-financiar-Janar-Qershor-2024-PDF.pdf - https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/07/Raporti-financiar-Janar-Qershor-2024-PDF-Scan.pdf - https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/07/Raporti-financiar-Janar-Qershor-2024.docx - 3.T-9 i publikuar më 8.10.2024: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/10/Raporti-financiar-Janar-Shtator-2024- PDF Scan.pdf - https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/10/Raporti-financiar-Janar-Shtator-2024- PDF Scan.pdf - https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/10/Raporti-financiar-Janar-Shtator-2024.docx - Përgjigjja: Raportet periodike financiare janë shqyrtuar për çdo periudhë 3-mujore në kuvendin e komunës së Rahovecit.	
Raporti përfundimtar financiar - data e publikimit	Në janar 2025 do të diskutohet ne Kuvendin Komunal	
Referenca - 2.2.2.	Janar – dhjetor 2024	Për muajin dhjetor 2024
1. Publikimi i Planit të Prokurimit për komunën përkatëse me kohë	Publikimi i planit paraprak të prokurimit: Publikimi i planit përfundimtar me 11.01.2024: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/01/Planifikimi-Perfundimtar-i-Prokurimit-per-vitin-fiskal-2024.pdf	
Publikimit i raportit për realizimin e planit të prokurimit me kohë		Publikohet në janar 2025
Kontrata të lidhura me kompani	Në vjegëzën më poshtë do ti gjeni kontratat e nënshkruara për vitin 2024: https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=30749	Raporti me kontratat e nënshkruara do të publikohet në janar 2025
Kontrata të publikuara në faqen ueb	Në vjegëzën më poshtë do ti gjeni kontratat e publikuara për vitin 2024: https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=30749	Në janar publikohet raporti i saktë me kontratat e publikuara
Referenca 3.1.1.	Janar – dhjetor 2024	Për muajin dhjetor 2024

<u>Përqindja bazuar në plotësimin e kushtit 14 ditë dhe gjuhët zyrtare për takimin e parë publik</u>	Njoftimi në gjuhen shqipe, i publikuar më 7.6.2024: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/06/Njoftim-takimi-i-pare-publik-i-kryetarit-per-vitin-2024.pdf ; Njoftimi në gjuhen serbe, i publikuar në : https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=32053&lang=sr	
<u>Përqindja bazuar në plotësimin e kushtit 14 ditë dhe gjuhët zyrtare për takimin e dytë publik</u>	Publikohet në dhjetor në ditët në vazhdim	
<u>Numri i pjesëmarrësve në konsultimet publike të komunës gjatë vitit</u>	Numri i pjesëmarrësve në konsultimet publike, gjithsej: 72 Numri i pjesëmarrësve femra: 21; Numri i pjesëmarrësve meshkuj: 51 Numri i pjesëmarrësve në takimet publike gjithsej: 114 Numri i pjesëmarrësve: 64; Numri i pjesëmarrësve meshkuj: 50 Numri i pjesëmarrësve në dëgjime publike gjithsej: 700 Numri i pjesëmarrësve femra: 265; Numri i pjesëmarrësve meshkuj: 435	Pjesëmarrësit e takimit të dytë publik do të mblidhen në janar pas përfundimit të takimit të dytë publik, i cili pritet të mbahet më 20 dhjetor
<u>Numri i banorëve në komunë</u>	56.208 sipas regjistrimit të fundit të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës : https://kk.rks-gov.net/rahovec/qyteti/numri-i-banoreve/	
Referenca 3.1.3.	Janar – dhjetor 2024	Për muajin dhjetor 2024
<u>Numri i akteve të miratuara me interes të përgjithshëm dhe i dokumenteve të politikave lokale në kuvendin komunal</u>		Pas publikimit të raportit vjetor të konsultimeve publike
<u>Numri i akteve të përgjithshme të miratuara në kuvendin komunal për të cilat është organizuar konsultim me publikun</u>		Pas publikimit të raportit vjetor të konsultimeve publike
Referenca 3.1.5.		
<u>Numri i dëgjimeve për buxhetin vjetor komunal</u>	Janë mbajtur 13 dëgjime publike nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa për përgatitjen e projekt-buxhetit komunal	
<u>2. Numri i konsultimeve publike për Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB)</u>	Janë mbajtur 5 dëgjime publike nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa për përgatitjen e KAB-it komunal	
Referenca 3.3.1.	Janar – dhjetor 2024	Për muajin dhjetor 2024
<u>Numri i aktivitete të planifikuara në planin e prokurimit</u>	https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/01/Planifikimi-Perfundimtar-i-Prokurimit-per-vitin-fiskal-2024.pdf	
Referenca 3.3.2.	Janar – dhjetor 2024	Për muajin dhjetor 2024
<u>2. Numri i pagesave që plotësojnë kërkesat ligjore për pagesë brenda 30 ditëve</u>		Pas përfundimit të muajit dhjetor

Lektorimi

Zyrtarja për lektorim, ka redaktuar gjuhësisht dokumentet e nxjerra nga Kryetari i Komunës, që ka lëshuar Zyra Ligjore, të tjera që kanë ardhur nga drejtoritë, duke përfshirë kërkesa për ministri, nga Kuvendi Komunal dhe nga komitetet e Kuvendit (procesverbale dhe vendime), si dhe dokumente të tjera të adresuara. Gjithsej, janë redaktuar: 851 dokumente.

Zyrtarja për lektorim merret edhe me: përpilimin e gazetës zyrtare mujore; raportin e punës së kryetarit; listën e aktiviteteve të kryetarit etj.

Zyra e Auditimit të Brendshëm

Kemi arritur të kryejmë 5 auditime, dhe një është në proces.

Auditimet e brendshme të kryera: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (subvencionet), DEZHT-i, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, Zyra e Prokurimit. Auditimi në Drejtorinë për Financa dhe Buxhet është në proces.

Zyra e Prokurimit

Kemi proceduar **gjashtëdhjetë e gjashtë (66)** aktivitete të prokurimit në vlerën: **20,261,718.47 €**; Janë nënshkruar **pesëdhjetë e pesë (55)** kontrata të të gjitha prokurimeve: **punë, furnizime, shërbime** në vlerën: **10,881,900.54 €**; **Dy** aktivitete të prokurimit janë me ankesë në OSHp; **Dy** aktivitete të prokurimit janë anuluar; **Shtatë (7)** aktivitete të prokurimit janë në procedura të prokurimit, sipas Ligjit të Prokurimit Publik; Personeli i Zyrës së Prokurimit ka proceduar: **1040 urdhër-blerjeje**, pagesa të ndryshme të investimeve kapitale, mallra dhe shërbime.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Terrene sportive në shkollën “Gëzim Hamza Piktari” dhe në ShMU “Rudolf Walther” në Dobidol.

Vazhdimi i programit të vaksinimit për fëmijët e moshës 0-12 vjeç, sipas kalendarit kombëtar të imunizimit, një projekt i mbështetur nga UNICEF-i.

Është krijuar dhe menaxhuar një databazë për personat e kthyer nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, e cila ndihmon në planifikimin dhe implementimin e masave mbështetëse për integrim.

Përmirësimi i infrastrukturës në vendbanimet e komuniteteve

ZKKK-ja ka asistuar mbi **50 raste me kërkesa të ndryshme** për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, përfshirë kërkesa për banim, mbështetje për riatdhesim, ndihma momentale, infrastrukturë dhe përfitime nga programet qeveritare

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Sektori i Gjendjes Civile

Gjatë këtij viti janë lëshuar:

Certifikata të lindjes	293 06	Lindjet vendore	37
Deklarata për bashkësinë familjare	167 3	Lindjet e jashtme	508
Certifikata të gjendjes martesore	143 3	Martetat vendore	497
Certifikata të martesës	427 3	Martetat e jashtme	75
Certifikata të shtetësisë	178	Vdekjet vendore	39
Certifikata të vendbanimit	242 9	Vdekjet e jashtme	96
Certifikata të vdekjes	103 2	Aktvdekjet	44
Vërtetime nga arkivi	119 9	Pranimi i atësisë	259
		Aktvendimet e korrigjimit të emrit ose të mbiemrit	15
		Aktvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të të lindurve	34
		Aktvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të të vdekurve	13
		Aktvendimet e ndërrimit të emrit dhe të mbiemrit	46

Sektori për Punë të Kuvendit dhe të Komiteteve

Në asistimin e Sektorit për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve, Janë mbajtur: 11 mbledhje të kuvendit, 11 mbledhje të KPF-së, 6 të Komitetit për Komunitete, 6 të KKS-së, 5 të Komitetit për Shëndetësi, 0 të K. për Arsim, 4 të K. për Auditim, 1 mbledhje e jashtëzakonshme, 0 mbledhje emergjente, 2 mbledhje solemne, 0 mbledhje përkujtimore.

Sektori për IT

Rikonfigurimi dhe inspektimi i kompjuterëve; monitorimi i sistemit të intranetit; funksionimi i faqes ueb; përkrahja e mbledhjeve të mbajtura në sallën e kuvendit; furnizimi me pajisje të teknologjisë informative; furnizimi me digjital-sender dhe i pajisjeve të teknologjisë informative; furnizimi dhe instalimi i kamerave në objektet e komunës; është nënshkruar kontrata për ndërtimin e dy e-kiosqeve në komunën e Rahovecit; mbikëqyrja e pajisjeve për printim, kopjim dhe skanim.

Qendra për Shërbime me Qytetarë

Mbajtja e dosjeve, e statistikave të parashtrësve dhe të kërkesave të paraqitura nga qytetarët, shtypja e librit të protokollit për kërkesat/parashtrës etj.

Kërkesat e pranuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2024

Drejtoria për Administratë	shenja e klasifikimit	nr. i kërkesave	të paguara	të liruara	gjithsej
Kërkesa/ankesa	320/04	5444	4914	530	5444
Mbajtës familjeje	040/01	677/10euro	677	//	7440
Vërtetime të ndryshme	320/04	357/2euro	357	//	815
Totali					12973

Sektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të objekteve

Ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbërim etj.). Kemi përfunduar procedurat për projektin: Sigurimi fizik i objekteve të Komunës; Menaxhimi i automjeteve (mirëmbajtja, servismi, sigurimi, regjistrimi i tyre, furnizimi transparent me derivate etj.).

Sektori për të Drejtat e Njeriut

Bashkëpunime me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare; këshillime të qytetarëve të cilët janë paraqitur në zyrë; bashkëpunim të ngushtë me zyrën e Avokatit të Popullit, me të cilët është punuar me theks të veçantë kundër diskriminimit të të gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit, pa dallim etnie e gjinie.

Sektori për Barazi Gjinore

Themelimi i Mekanizmit Komunal Koordinues kundër dhunës në familje në komunën e Rahovecit; Përgatitja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor për KAB-in 2025-2027; Formimi i Asamblesë Komunale të Fëmijëve; Konsultimi publik për përgatitjen e projektplanit lokal të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore 2024-2026.

Të hyrat në Drejtorinë e Administratës për vitin 2024 janë: 70,148.00 euro.

Treguesit e performancës: Treguesi 1.1.1. - Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit - janë shqyrtuar 45,831 kërkesa, bashkëngjitur është raporti nga sistemi i intranetit.

Treguesi 1.1.2. - Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore - janë 866 kërkesa të shqyrtuara me vonesë.

Treguesi: 1.1.3. - Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna - Gjatë periudhës raportuese, janë lëshuar 890 certifikata të gjendjes civile në e-kiosqe.

Treguesi 1.1.4. - Shërbimet administrative të thjeshtuara për zvogëlimin e barrës administrative në nivel komunal

Vërejtje: Te treguesi 1.1.4. - Shërbimet administrative të thjeshtuara për zvogëlimin e barrës administrative në nivel komunal, këtë viti do të plotësojmë këtë tregues, andaj duhet të përgatisim një plan për minimum 10 procedura administrative që do të thjeshtohen dhe që do të aplikohen për vitin 2025. Pasi të identifikohen këto 10 procedura, atëherë kryetari para datës 31.12.2024 duhet të bëjë aprovimin.

DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

Shpenzimi i buxhetit është arritur në 94.66%, ndërsa të hyrat e përgjithshme janë tejkaluar në raport me planin në 18.23%.

➤ **Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2024 ndahet në dy fonde burimore:**

- Granti i qeveritar 18,189,882.00€
- Të hyrat vetanake 1,614,904.00€
- gjithsej: 19,804,785.56 €


➤ **Buxheti fillestar për vitin 2024 i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:**

- Paga dhe Mëditje 10,407,313.56€
- Mallra dhe Shërbime..... 2,466,340.00€
- Shpenzime Komunale 390,000.00€
- Subvencione dhe Transfere 890,000.00€
- Investime Kapitale..... 5,651,132.00€
- Rezervat.....000.000.00 €

JANAR- DHJETOR BUXHET, ALOKIM, SHPENZIM

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti fillestar	Buxheti final	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim/ Buxheti final %	Shpenzim/ Alokim %
Paga dhe Mëditje	-	10,407,313.56	10,407,313.56	10,134,904.19	10,013,146.14	96.21	98.80
Mallra dhe Shërbime	2046	2,466,340.00	2,546,449.74	2,546,449.74	2,354,430.77	92.46	92.46
Shpenzime Komunale	643	390,000.00	390,000.00	390,000.00	325,384.80	83.43	83.43
Subvencione dhe Transfere	238	890,000.00	960,562.30	960,562.30	951,979.31	99.11	99.11
Investime Kapitale	187	5,651,132.00	6,154,560.52	6,154,560.52	5,871,170.04	95.40	95.40
Donacione	-	-	1,009,650.56	1,009,650.56	805,084.89	79.74	79.74
Totali	3114	19,804,785.56	21,468,536.68	21,196,127.31	20,321,195.95	94.66	95.87

- Sqarim: Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për arsye të bartjes së mjeteve të mbetura nga viti 2024 në kategorinë e investimeve kapitale, donacionet, granti i performancës, alokimi i huamarrjes në arsim dhe në shëndetësi në



kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. 4.1. Paraqitja grafike

Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2024 janë: 1,614,904,00 euro. Për këtë periudhë janë realizuar në shumën: 1,909,335.83€, apo 118.23% të planifikimit vjetor.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Sektori i Tatimit në Pronë ka realizuar të hyra në shumën prej 905,887.82€ apo 127.87% të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 708,419.00€). Regjistrimet e reja janë 265 objekte ose 43.343 m². Verifikimi i objekteve: 3683 ose 581.718 m².

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

AKTIVITETET

- Është bërë shqyrtimi dhe përgjigjja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, kryesisht për ndihma momentale – financiare, prej të cilave 526 janë të miratuara;
- Ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime në dy QMF-të në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc, shërbimet mjekësore me dy ndërrime tanimë janë të përhershme;
- Po vazhdon funksionimi shërbimit mjekësor "Kujdesi shtëpiak";
- Janë kryer vizitat sistematike të nxënësve në shkollat e komunës së Rahovecit;
- Në QKMF "Fahredin Hoti" në Rahovec, funksionon aparati i mamografisë, i cili shërben për ta identifikuar dhe diagnostikuar me kohë kancerin e gjirit;
- Janë mbështetur OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale;
- Janë evidentuar dhe shpërndarë thirrje-ftesat për vaksinimin e fëmijëve në komunën tonë.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Vazhdon furnizimi me barna nga lista esenciale nga buxheti i komunës;
- Vazhdon renovimi i objekteve të QMF-ve;
- Është bërë përrurimi i objektit të QMF-së në Ratkoc dhe në Krushë të Madhe;
- Ka përfunduar rinovimi i repartit të hemodializës.

Mirëqenia Sociale:

Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale - është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia, duke bashkëpunuar me donatorë vendorë e të huaj, shoqata të ndryshme joqeveritare, grupe ekspertësh etj.

Indikatorët e performancës

Referenca 4.2.1.

1. Numri i përgjithshëm i familjeve të cilave u është siguruar banimi social nga komuna gjatë vitit është 5 (strehim i përkohshëm);
2. Numri i familjeve të regjistruara në komunë që kanë nevojë dhe që i plotësojnë kushtet për banim social, është 5 (me vendim dhe me marrëveshje).

Referenca 4.2.2.

1. Numri i kërkesave të fëmijëve me nevojë për strehim, që u është siguruar strehimi familjar, është 12;
2. Numri i fëmijëve në nevojë të vendosur në familjet strehuese, është 12;
3. Programi trevjeçar komunal i banimit social është 2022-2025, mirëpo ende nuk është funksional.

Kujdesi Parësor Shëndetsor

Referenca 15.1.1.

1. Gjithsej numri i QKMF-ve: Eshte vetëm një qendër kryesore e mjekësisë familjare;
2. Gjithsej numri i QMF-ve është shtatë: Drenoc, Çifllak, Ratkoc, Fortesë, Krushë e Madhe, Opterushë, Rahovec
3. Gjithsej numri i QMF-ve të cilat përmbushin kërkesat për inventarë, mjete dhe ofrimin e shërbimeve laboratorike dhe radiologjike: QMF-ja në Krushë të Madhe ku ka vetëm një laborator.
4. Gjithsej numri i AMF-ve është 8: Xërxë, Radoste, Brestoc, Lagjja e Trimave, Lagjja e serbve, Hoçë e Madhe, Polluzhë, Zaqishtë.
5. Gjithsej numri i të cilave përmbushin kërkesat për inventarë, mjete: të gjitha AMF-të i përmbushin kërkesat për inventarë.

Referenca 15.2.1.

1. Gjithsej numri i ekipeve të mjekësisë familjare: 34 ekipe (34 mjekë dhe 80 infermierë);
2. Gjithsej numri i ekipeve të stomatologjisë: 9 ekipe (9 mjekë dhe 6 infermierë).

Referenca 15.3.1

1. Gjithsej fëmijë të planifikuar për program të imunizimit: 3831;
1. Gjithsej fëmijë në program, të cilët janë imunizuar për këtë periudhë janë: 2270

Arsyetim: diferenca e numrave është se një pjesë janë jashtë vendit dhe pjesa tjetër të komunitetit RAE

Referenca 15.3.2

1. Ofrimi i shërbimit specialist për gra dhe fëmijë është: 20919

DREJTORIA PËR ARSIM

Furnizimi i shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike nga kimia, fizika, matematika, biologjia, gjeografia e historia (Me realizimin e këtij projekti ne kemi rritur edhe treguesin e **performancës komunale, përkatësisht treguesin 14.1.3**); furnizimi i bibliotekave të shkollave me libra; pranimi i 100 robotëve edukativë; Gara Komunale të Olimpiadës së Fizikës.

Projekti i eficiencës së energjisë në Gexhë, ndërsa në Çifllak punime në rregullimin e fushës sportive në oborrin e shkollës (**Këto dy projekte rrisin performancën komunale, sidomos treguesin 14.1.1**).

Funksionimi i tri çerdheve të reja (**treguesi 14.2.2. i performancës komunale**).

Rregullimi i nyjave sanitare në objektet e shkollave në Drenoc, Senoc, në objektin e IAAP “Selajdin Mullaabazi-Mici” dhe në objektin e ShML “Ukshin Hoti”; kanë përfunduar punimet në ShFMU “Bekim Sylka”, e po ashtu ka përfunduar puna në drenazhimin përreth objektit të ShML “Xhelal Hajda –Toni”; ndërtimi i 3 rrethojave të oborreve të shkollave, në Dobidol, në Vrajakë-Bratotin dhe te çerdhja për fëmijë “Tulipanët” (**rritja e treguesit 14.1.2 të performancës komunale**); ka përfunduar lyerja e mureve të brendshme në të dyja objektet e ShFMU “Isa Boletini” në qytet.

Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Profesionale të Informaticientëve të Kosovës (ShPIK) për fillimin e zbatimit të projektit të kodimit në fushën e teknologjisë informative; Furnizimi me inventarë i 3 çerdheve të reja; Fusha sportive në oborrin e ShFMU “31 Marsi” në Gur të Kuq.

Janë dhënë 196 bursa për studentët dhe 40 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta.

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Janë subvencionuar 12 biznese *start up*, ku 4 nga këto biznese menaxhohen nga gratë;

Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për financimin e parkut industrial në Opterushë, faza e dytë;

Kanë përfunduar punimet në projektin “Ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit”;

Ka përfunduar ndërtimi i 10 shtandeve mobile;

Përrurimi i projektit: “Ndërtimi i lokaleve afariste zejtare në Rahovec”;
Funksionalizimi i shtëpisë për të moshuar, me qëndrim ditor.

Spektori për Ekonomi:

Të hyrat dhe ngarkesa në taksë afariste:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë komunale për vitin 2024	83,663.00€

Spektori për Zhvillim:

Të hyrat nga qiratë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiratë për vitin 2024	87,975.88€

Zyra e QKRB-së:

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar-shtator 2024:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	145
2	Informata të ndryshme	230
3	Vërtetim Individual	20
4	Shuarje të biznesit	23
5	Shuarje të njësisë	3
6	N.U.I.	40
7	Njësi e re	2
8	Certifikata dublikate	5
9	Ndërrimi i tipit të biznesit	3
10	Ndryshime në biznes	89
11	Punë të tjera me palë	29
	Gjithsej lëndë të përfunduara	589

Menaxhimi i aseteve komunale

Spektori i Turizmit

Kanë vazhduar Investimet në zgjerimin e shtigjeve të ecjes në Zatriq dhe në Zaqisht;
Janë shenjzuar mbi 20 km shtigje për ngjitje (hiking) në tërë territorin e komunës së Rahovecit;

Në raportin e performancës për vitin 2024, DEZHT-i, në të dy indikatorët ka treguar performancë të lartë:

- Treguesi: 16.1.1. - Strategjia për zhvillim ekonomik lokal, me pikë 100%;
- Treguesi: 16.1.2. - Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim, me pikë 100%.

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit

Në Sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë shqyrtuar: leje ndërtimi, leje përdorimi, leje rrënimi, kushte ndërtimore, shkresa, pëlqime, legalizime të objekteve etj.

Të hyrat e përgjithshme:

Parallogaria	46591,00€
Legalizime	5109,57€
Vërtetime –pëlqime	4020,00€
Leje mjedisore	2238.57
Totali i të hyrave	57,959.11€

Sektori i Mjedisit

Në bazë të Sektorit të Mjedisit lëshojmë leje mjedisore komunale dhe leje ujore komunale. Në total 24 leje mjedisore, nga të cilat 21 janë aprovuar dhe tri janë refuzuar. Numri i të hyrave: 2238.54€;

- Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031
- **Harta Zonale Komunale 2024-2032 – draft-dokument.**

Projektet e përfunduara gjatë vitit 2024:

Ndërtimi i parqeve në komunën e Rahovecit (Kramovik, Gur i Kuq, Çifllak, Brestoc, Drenoc, Xërxë, Pataqan i Epërm, Krushë e Madhe, Opterushë -muret dekorative, Ratkoc, Fortesë; ndërtimi i shtratit të përroit në Polluzhë; kolektori për ujërat e zeza në Ratkoc dhe në Rahovec; ndërtimi i ndërtesës së përbashkët për banim të familjeve me nevojë-faza përfundimtare; bustet e dëshmorëve (Gëzim Hamza-Piktori, Sadedin Hajda dhe Mizahir Isma); Hartimi i Planit të Vlerësimit Mjedisor

Realizimi i planit për eficiencë (në shkollat në: Rahovec, Ratkoc, Gexhë, Çifllak, Celinë, Zatriq etj.)

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Ka përfunduar ndërtimi i disa segmenteve rrugore: **Gur i Kuq**: 5 segmente; **Sapniq**: 6 segmente; **Pataqan i Poshtëm**: 5 segmente; **Pataqan i Epërm**: 2 segmente; **Nashpall**: 2 segmente; **Ratkoc**: 7 segmente; **Rahovec**: 2 segmente; **Çifllak**: 5 segmente; **Nagac**: 1 segment; **Brestoc**: 2 segmente; **Zaqisht**: 4 segmente; **Kramavik**: 2 segmente.

Rruga **Sapniq-Nashpall** (marrëveshje me M. e Infrastrukturës); Rruga në **Çifllak** (300 metra); Rruga në **Malësi të Vogël** (në ndërtim).

Menaxhimi i mbeturinave.

Ndërtimi i trotuareve: **Hoçë e Vogël**, **Gur i Kuq** (700 metra); **Sapniq**, **Drenoc**, **Fortesë**, **Brestoc**.

Kanalizime: **Lagjja “Vëllezërit Frashëri”**, **Dejnë**; **Projekti për kanalizimin e ujërave fekale në Xërxë**.

Kanal i ujërave atmosferike në **Dejnë**; Ndërtimi i shtratit të lumit në **Sapniq** (400 metra deri tani).

Zgjerimi i ndriçimit publik: **Retijë**, **Retijë e Ulët**, **Polluzhë**, **Zatriq**.

Zëvendësim i poqëve sipas kontratës **ESCO**.

Zgjerimi i kamerave të sigurisë.

Ndërtimi i gropave bioseptike: **Polluzhë**, **Reti**, **Rahovec** (1 gropë), **Pataqan i Poshtëm**, **Pataqan i Epërm**, **Pastasel**.

Bashkëpunim me **KRU “Gjakova”**: Rrjeti i ujësjellësit: **Rahovec-Zona Ekonomike**; **Ratkoc-Vrajak-Bratatin**.

Rregullimi i murit mbrojtës dhe i rrugës në **Krushe e Madhe**.

Riparimi i gropave në rrugë brenda qytetit.

Asfaltimi i rrugës **“Gëzim Hamza”**.

Performanca komunale-indikatorët nga DShP-ja

- ➡ Gjithsej janë 19 fusha në total të përfshira si kritere në performancën komunale
- ➡ 6 fusha dhe 23 tregues janë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike

Fusha 8: Hapësirat Publike - janë 3 tregues. Qëndron një përqindje prej (28.86, 99.08 dhe 96.69 %), totali 74.87 %;

Fusha 9: Infrastrukturë rrugore - janë gjithsej në këtë fushë 7 tregues, përmirësime kemi në shtigjet urbane të biçikletave, është rritur përqindja në krahasim me vitin paraprak në 72.38%;

Fusha 10: Transporti publik - janë 3 tregues, në këtë fushë kemi 100 %;

Fusha 11.1.: Uji i pijshëm - 2 tregues janë gjithsej, ku komuna jonë mbulohet me 100 % të mbulueshmërisë së territorit;

Fusha 11.1.2.: Kanalizimi - në këtë fushë janë gjithsej 3 tregues, dy tregues janë 100 % ndërsa treguesi i tretë, që i përket impiantit të ujërave të zeza, është i ngrirë për shkak të kostove të mëdha që kanë këto projekte;

Fusha 11.1.3.: Menaxhimi i mbeturinave - janë gjithsej 5 tregues në këtë fushë, komuna jonë është duke realizuar në tërësi planin në menaxhim të mbeturinave.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Aktivitetet në gjashtëmujorin e parë:

Pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024 për fermerët blegtorë (MBPZhR), hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZhR-së pranon aplikacionet dhe i dorëzon në ministri për pagesë. Gjithsej kanë aplikuar **91** blegtorë, me gjithsej: **1,709,950** litra qumësht dhe **522** krerë të viçave për majmëri; Është nënshkruar kontrata me Qendrën Grumbulluese “Agro Celina”, e cila do të furnizojë bujqit me fidanë dhe me inpute të tjera për kulturën e trangullit “kornishan”. Përmes kësaj marrëveshjeje do të mbulohen: Fidanët cilësorë të trangullit, plehërimi dhe riplehërimi (kristalorët), pesticidet, mulqerimi (folia e zezë), sistemi i ujitjes pikë-pikë; Trajtimi, kontrolli dhe vaksinimi i bagëtive të trasha dhe i bagëtive të imëta - vaksinimi i bagëtive: **1,915** krerë lopë dhe rreth **7,500** dele. Gjithsej janë vizituar 121 ferma blegtorale.

Përkrahja e vreshtarëve me preparate për luftimin e insektit “CIKADIA” e hardhisë së rrushit

Thirrja për aplikim	Afati për aplikim	Nr. i përfituesve
Furnizim me preparate	06.03.2024 - 20.03.2024	495 vreshtarë
Rishpallja e thirrjes	24.05.2024 - 03.06.2024	82 vreshtarë

Përkrahja e fermerëve me pleh artificial

Thirrja për aplikim	Afati për aplikim	Numri i përfituesve
Pleh artificial	02.05.2024 - 22.05.2024	1128 fermerë

Pagesat direkte - subvencionet:

Të dhënat e fermerëve		2022	2023	2024	Diferenca 2024/2023
Sektori i lavërtarisë		sip. në ha	sip. në ha	sip. në ha	sip. në ha
1	grurë	2,006.21	2,743.61	2520.53	-223.08
2	misër	1,578.94	1,943.60	1875.96	-67.64
3	elb	4.05	1.12	6.5	5.38
4	tërshërë	122.04	80.01	99.9	19.89
5	thekër	0.00		1.72	1.72
gjithsej:		3,711.24	4,768.34	4,504.61	-263.73
Sektori i vreshtarisë		sip. ne ha	sip. në ha	sip. në ha	

	Lloji i kulturës				
1	rrush	2,322.21	2,274.57	2,216.29	-58.28
2	fidanë të hardhisë	149,900.00	124,000.00	127,000.00	3,000.00
Spektori i perimekulturës		sip. në ha	sip. në ha	sip. në ha	
1	speca	695.30	616.41	695.30	78.89
2	domate	11.48	9.66	17.41	7.75
3	qepë	149.76	186.78	235.47	48.69
4	hudhër	25.56	20.37	14.66	-5.71
5	patate	166.35	189.22	260.02	70.80
6	tranguj	0.43	0.74	0.61	-0.13
7	karota	7.65	7.14	6.38	-0.76
8	rrcepë	0.00	0.49	0.00	-0.49
9	brokoli	0.25	0.00	0.30	0.30
10	fasule	0.46	1.90	2.70	0.80
11	panxhar	0.00	0.00	0.00	0.00
12	lakër	144.20	70.65	134.97	64.32
13	lulelakër	10.82	10.23	8.06	-2.17
14	preshe	0.20	0.00	0.57	0.57
15	spinaq	0.84	0.48	0.85	0.37
16	marule	0.64	0.90	1.68	0.78
gjithsej:		1,213.94	1,114.97	1,378.98	264.01
Kungullore		sip. në ha	sip. në ha	sip. në ha	
1	shalqinj	164.68	171.68	353.99	182.31
2	pjepër	100.24	84.49	98.71	14.22
3	kunguj	11.82	6.58	23.80	17.22
4	kungulli i gjelbër	302.84	160.41	242.77	82.36
Gjithsej		579.58	423.16	719.27	296.11
Spektori i pemëtarisë		sip. në ha	sip. në ha	sip. në ha	
1	dardhë	6.63	7.81	3.46	-4.35
2	luleshtrydhe	2.72	2.09	1.19	-0.90
3	kumbull	54.86	62.65	49.92	-12.73
4	mollë	8.96	10.26	8.70	-1.56
5	arra	73.90	95.15	92.86	-2.29
6	lajthi	10.77	9.22	9.52	0.30
7	ftonj	4.17	3.86	3.86	0.00
8	mjedër	0.53	0.00	0.00	0.00
9	pjeshkë	2.69	3.27	2.96	-0.31
gjithsej:		165.23	194.31	172.47	-21.84
Spektori i blegtorisë dhe i shpezërisë					
1	bletë	4,245.00	4,793.00	5,276.00	483.00
2	lopë	1,938.00	1,953.00	1,966.00	13.00
3	dhi	248.00	167.00	150.00	-17.00
4	dele	7,226.00	7,396.00	5,244.00	-2,152.00
5	pula vojëse	59,100.00	60,260.00	52,000.00	-8,260.00

Nr.	lloji I kulturës	sip. në ha	sip. në ha	sip. në ha	
1	BMA	16.51	8.54	10.96	2.42
					0.00
Perime në serra					0.00
1	perime	24.26	27.21	28.77	1.56

- Trajtimi i qenve endacakë

Aktivitetet në gjashtëmujorin e dytë:

Nënshkrimi i kontratave me fermerë, si dhe pjesa e participimit prej 20%, për pleh artificial.

Shpërndarja e plehut për fermerët të cilët e kanë kryer participimin në fazë të parë, sasia e shpërndarë është **5,000 thasë**, për **547** fermerë.

Sipërfaqja e aplikuar për subvencionim të plehut artificial: **3935 ha**;

Numri i viçave: **692 viça**;

Sasia e qumështit: **1,899,154 litra**;

Thirrja “**Përkrahja e fermerëve me serra për fermerët e komunës së Rahovecit**”, ku gjithsej kanë aplikuar **135** fermerë;

Gjatë muajve gusht dhe shtator është bërë organizimi i festave me karakter bujqësor, si “Agrofest” dhe Festa e Vjeljes së Rrushit – Hardhfest;

Janë shpërndarë **57,700€** për **247** fermerë blegtorë e ku janë përfshirë edhe fermerët e vegjël, të cilët nuk përfshihen në skemën e subvencioneve të MBPZhR-së.

Ndërtimi i serrave për fermerë:

Përkrahja e fermerëve me serra	serra 3 ari	serra 5 ari
Lista e parë	22 përfitues	26 përfitues
Lista me ankesë	35 përfitues	7 përfitues

Shpërndarja e plehut për fermerët të cilët e kanë kryer participimin në fazë të dytë, sasia e shpërndarë është **4,000** thasë për **375** fermerë;

Pjesa e fundit e shpërndarjes së plehut artificial: **125** fermerë përfitues me **1,020** thasë.

Kanali i kullimit të tokave bujqësore në Ratkoc; Kanali i kullimit nga Shtavica deri në Fortesë;

Kanali i kullimit në Çifllak; Kanali i kullimit Fortesë – Celinë; Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore.

-Pastrimi i përrrenjve.

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Gjatë periudhës janar-dhjetor të punës për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët:	Shuma në €
Kadastër dhe Pronë	1276	24,000€
Gjeodezi	910	26,693€
Referenti	2,002+70 (L.Z.)	12,000€
Totali	4,188+70 (L.Z.)	62,693.00€

Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privatë për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim të pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim të paluajtshmërisë, ndarje të bashkësisë familjare etj.;

Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje të planit;

Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte, si: koordinata, modifikime etj.;

Kemi përgatitur materialin për dhënien e pronës me qira, interes të përgjithshëm, vendim për këmbim etj.;

Sipas afatit, lëndët i kemi pranuar dhe aprovuar me kohë në intranet;
 Përgjigje në kërkesat e personave juridikë dhe fizikë;
 Me kërkesë të qytetarëve për falje të pronës private në pronë publike, në të gjitha zonat kadastrale për hapje të rrugëve publike në interes të përgjithshëm, gjeodetët kanë dalë në terren dhe kemi përgatitur dokumentacionet e nevojshme për zhvillimin e këtyre procedurave;
 Zhvillimi i procedurave për shpronësim të parcelave ku është pompa e derivateve në qytet dhe parcela ku operon për momentin kafeneja “Hardhia”, procesi ka përfunduar dhe prona tashmë është në pronësi të Komunës;
 Kemi përgatitur listën e veçantë dhe listën e përgjithshme të pronave, të cilat planifikojmë t’i japim me qira brenda vitit 2025; është në proces digjitalizimi kadastral- vektorizimi i zonave kadastrale në nivel të komunës, operatori ka filluar që t’i dorëzojë materialet e zonave kadastrale të vektorizuara.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Mbështetja e 29 OJQ-ve përmes thirrjes publike për subvencionim në vlerë prej **189.400€**, krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje mbi **17%** të subvencioneve;
 Aktivitete përkujtimore e kulturore; Festivali “Anadrinia Jehon”;
 Aktivitete për muajin e mërgimtarëve;
 Rregullimi i terreneve sportive në vendbanimet e komunës sonë, si: në Krushë të Madhe, në Xërxë, në Dejnë, në Çifllak, në Gur të Kuq, në Hoçë të Vogël;
 Aneksi të shtëpia e kulturës në Krushë të Madhe;
 Kompleksi Sportiv në Rahovec - është përfunduar fusha e futbollit të madh dhe e hapësirave të tjera përcjellëse në kompleks, duke përfshirë zhveshtoret, fushat ndihmëse sportive, shtegun e atletikës;
 Punime në ndërtimin e Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec;
 Ndërtimi i shtëpisë-muze “Bajram Curri”

BIBLOTEKA KOMUNALE “SULEJMAN KRASNIQI”-RAHOVEC

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit

Shërbime me libra gjatë muajve janar- dhjetor: 498 vajza dhe 321 djem.

Fondi total i librave në bibliotekën komunale “Sulejman Krasniqi” në Rahovec, është: 27981 libra. Në bibliotekën në Rahovec janë 21583 libra, në Krushë të Madhe 4558 libra dhe në Ratkoc 1840 libra.

PALESTRA E SPORTEVE “MIZAHIR ISMA”

Janë zhvilluar 28 (njëzet e tetë) ndeshje zyrtare në palestër. Zhvillojnë ndeshjet klubet e hendbollit, të futsallit, të basketbollit etj. Zhvillohen aktivitete e turnirë të ndryshëm.

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Në total, janë realizuar 670 inspektime dhe janë shqiptuar 186 gjoba për shkelje të rregulloreve dhe ligjeve në fuqi.

Spektori i Ndërtimit - janë inspektuar dhe riinspektuar 160 objekte ndërtimore.

Spektori i Mjedisit - janë kryer 93 inspektime për kontrollin dhe mbrojtjen e mjedisit.

Spektori i Çështjeve Komunale - Menaxhimi i hapësirave publike

Spektori i Tregut - ka mbikëqyrur dhe kontrolluar bizneset dhe tregtarët për të siguruar që ato të ofrojnë produkte të sigurta dhe të respektojnë normat për çmimet dhe etiketimin.

Spektori i Transportit Publik dhe Komunikacionit - ka mbikëqyrur kompanitë e licencuara për transportin e udhëtarëve dhe ka siguruar që ato të përmbushin kërkesat e rendit dhe sigurisë.

Indikatorët e performancës:

FUSHA 7: PLANIFIKIMI HAPËSINOR KOMUNAL

Komuna	Rahovec
Referenca	7.2.2.
Fusha	PLANIFIKIMI HAPËSINOR KOMUNAL
Rezultati	Ndërtim i planifikuar komunal
Emri i treguesit	Ndërtesa të reja të inspektuara

- Numri i përgjithshëm i objekteve të reja të inspektuara gjatë vitit të raportimit: 160;
- Numri i objekteve të reja me leje të ndërtimit nga objektet e inspektuara: 54.

FUSHA 15: MBROJTJA E MJEDISIT

Komuna	Rahovec
Referenca	12.1.3.
Fusha	MBROJTJA E MJEDISIT
Rezultati	Krijimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm
Emri i treguesit	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale

- Numri i objekteve të reja për të cilat kërkohet leje mjedisore të inspektuara gjatë vitit të raportimit: 30;
- Numri i gjobave të shqiptuara për mosposedimin dhe zbatimin e LMK: 6;
- Numri i fletëparaqitjeve në gjykatë për mosposedimin dhe zbatimin e LMK: 8.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Inspektimi i lumenjve, i përroskave dhe i kanaleve të hapura në të gjithë territorin e Komunës; Inspektimi i rregullt i objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve;

Servisimi i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në objektet e Komunës së Rahovecit dhe të zyrave të administratës publike në të gjithë territorin e Komunës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, në çerdhe, në QKMF dhe në QMF-të, në shtëpitë e kulturës, në muze dhe në palestrën e sporteve;

Inspektori për parandalim ka pasur 11 verifikime për dhënien e pëlqimit për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e objekteve dhe 18 dalje për verifikimin dhe hulumtimin e shkaqeve të zjarreve të ndodhura;

Komisioni komunal për vlerësim të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, ka vlerësuar 513 kërkesa për vlerësim të dëmeve, kryesisht në kultura bujqësore dhe në serra.

Fusha 6 - Menagjimi i fatkeqësive, indikatorët e performancës

- *Niveli i realizimit të Planit Komunal për Reagim Emergjent* - për çdo fatkeqësi natyrore e cila është me rrezikshmëri të lartë, aktivizohet Plani i Reagimit Emergjent Komunal, në të cilin plan janë të detajuara detyrat dhe përgjegjësitë e çdo institucioni që vepron në komunë.
- *Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera*- të gjitha këto informata janë nga NJPZSh-Rahovec, po ashtu me këto të dhëna janë të informuar edhe AME-MPB. Për çdo muaj këto informata përcillen në këto institucione.

PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet theksat kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Raporti i punës për vitin 2024, është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.

Bashkërisht me ekipin tim qeverisës, kemi gatishmërinë, energjinë dhe diturinë, të gjitha këto t'i vëmë në dispozicion të qytetarëve, që Komuna e Rahovecit të ofrojë shërbime sa më cilësore.

Të vendosur për menaxhim të mirë të pronës publike, duke krijuar kushte më të mira për zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, bujqësi, infrastrukturë, mirëqenie sociale, kulturë, rini dhe sport, në të ardhmen na presin angazhime edhe më të mëdha për të mirën e të gjithëve, pa dallim.

Ju faleminderit!

Rahovec, dhjetor 2024

Kryetari i Komunës

